

# KIS Interpretimi 12

## ***Konsolidimi – Njësitë ekonomike për qëllime të veçanta***

### Referencat

---

- SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*
- SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*
- SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*
- SNK 32 *Instrumente financiare: Paraqitja*
- SNRF 2 *Pagesa të bazuara në aksione*

### Çështje

---

- 1 Një njësi ekonomike mund të krijohet për të përmbushur një objektiv të ngushtë dhe të mirëpërcaktuar (p.sh. për të kryer aktivitete qiraje, kërkimi dhe zhvillimi, ose një proces krijimi të instrumenteve financiare (letrave me vlerë) të aktiveve financiare). Kështu, një njësi ekonomike për qëllime të veçanta ('NEPQV') mund të jetë në formën e një korporate, trusti, bashkëpronësie ose një njësie ekonomike të painkorporuar. Shpesh, NEPQV -të krijohen sipas marrëveshjeve ligjore që imponojnë kufizime të rrepta dhe disa herë të përhershme në lidhje me fuqinë vendimmarrëse të Bordit drejtues, administratorit të besuar ose drejtimin mbi veprimtarinë e njësisë ekonomike për qëllime të veçanta (NEPQV). Shpesh herë, këto kushte specifikojnë që politika për udhëheqjen e aktiviteteve në bazë vijimësie të njësisë ekonomike për qëllime të veçanta (NEPQV) nuk mund të modifikohet, me përjashtim të rastit kur kjo bëhet nga krijuesit ose financuesit e tyre (d.m.th. ato veprojnë sipas të ashtuquajturit 'autopilot').
- 2 Financuesi (ose njësia ekonomike në emrin e të cilit është krjuar NEPQV), që shpesh i transferon aktivet në NEPQV, ka të drejtën të përdorë aktivet e mbajtura prej saj ose kryen shërbime për të, ndërsa palët e tjera ('siguruesit e kapitalit') mund të bëjnë financim në NEPQV-të. Një njësi ekonomike, që hyn në transaksione me një NEPQV (shpesh herë krijuesi ose financuesi), mundet që në thelb ta kontrollojë atë.
- 3 Interesi i leverdisshëm në një NEPQV mund të marrë formën, për shembull, të një instrumenti borxhi, një instrumenti kapitali neto, e një të drejte pjesëmarrjeje, një interesi të mbetur ose të qirasë. Nga disa prej interesave të leverdisshëm, mbajtësi mund të sigurojë thjesht një normë kthimi fikse ose të shpallur, ndërsa nga të tjera ai mund të përftojë të drejtën ose mundësinë për të marrë pjesë në përfitimet ekonomike të ardhshme nga aktivitetet e NEPQV-së. Në shumicën e rasteve, krijuesi ose financuesi (ose njësia ekonomike në emër të së cilës është krjuar NEPQV) ruan një interes të leverdisshëm të konsiderueshëm në aktivitetet e NEPQV-së, edhe pse mund të ketë pak ose aspak pjesë në kapitalin neto të saj.
- 4 SNK 27 kërkon që të bëhet konsolidimi i njësisë ekonomike që janë të kontrolluara nga njësia raportuese. Megjithatë, Standardi nuk jep një udhëzim të drejtpërdrejtë mbi konsolidimin e NEPQV-ve.
- 5 Çështja është se në cilat rrethana një njësi ekonomike duhet të konsolidojë një NEPQV.
- 6 Ky Interpretim nuk zbatohet në skemat e përfitimeve të pas-punësimit ose në skemat e përfitimeve afatgjata të punonjësve për të cilat zbatohet SNK 19.
- 7 Një transferim i aktiveve nga një njësi ekonomike tek një NEPQV mund të kualifikohet si një shitje nga kjo njësi. Edhe në qoftë se transferimi nuk kualifikohet si një shitje, sipas SNK 27 dhe këtij Interpretimi mundet që njësia ekonomike të konsolidojë NEPQV. Ky Interpretim nuk jep rrethanat në të cilat duhet të bëhet trajtimi i shitjes për njësinë ekonomike ose eliminimi i pasojave të një shitjeje të tillë me konsolidimin.

### Konsensusi

---

- 8 Një NEPQV do të konsolidohet kur përmbajtja e marrëdhënive të saj me një njësi ekonomike tregon se ajo kontrollohet nga kjo njësi ekonomike.
- 9 Në kontekstin e një NEPQV-je, kontrolli mund të lindë nëpërmjet paracaktimit të aktiviteteve të saj (drejtimi me 'autopilot') ose ndryshe. SNK 27.13 përcakton disa rrethana në të cilat kontrolli ekziston edhe në rastet kur

njësia ekonomike zotëron gjysmën ose më pak se gjysmën e aksioneve me të drejta votuese të një njësie ekonomike tjetër. Në mënyrë të ngjashme, kontrolli mund të ekzistojë edhe në rastet kur një njësi ekonomike zotëron pak ose aspak nga kapitali neto i NEPQV-së. Përdorimi i konceptit të kontrollit kërkon që, në çdo rast, gjykimi të bëhet në kontekstin e të gjithë faktorëve përkatës.

- 10 Përveç situatave të përshkruara në SNK 27.13, rrethanat e mëposhtme mund të tregojnë, për shembull, një marrëdhënie në të cilën një njësi ekonomike kontrollon një NEPQV dhe rrjedhimisht duhet ta konsolidojë atë (në shtojcën e këtij Interpretimi jepet për këtë një udhëzim shtesë):
- (a) në përmbajtje, aktivitetet e NEPQV-së kryhen në emër të njësisë ekonomike sipas nevojave specifike të biznesit të saj, kështu që kjo njësi ekonomike siguron përfitime nga shfrytëzimi i NEPQV-së;
  - (b) në përmbajtje, njësia ekonomike ka fuqinë e vendimmarrjes për të përfutur pjesën më të madhe të përfitimeve nga aktivitetet e NEPQV-së ose, me anën e ndërtimit të një mekanizmi ‘autopilot’, njësia ekonomike i ka deleguar këto fuqi vendimmarrëse;
  - (c) në përmbajtje, njësia ekonomike ka të drejtën për të marrë pjesën më të madhe të përfitimeve të NEPQV-së, prandaj ajo mund të jetë e ekspozuar ndaj rreziqeve rastësore në aktivitetet e NEPQV-së; ose
  - (d) në përmbajtje, njësia ekonomike mban pjesën më të madhe të rreziqeve të pronësisë apo të interesave të mbetur në lidhje me NEPQV-në ose aktivet e saj me qëllim marrjen e përfitimeve nga aktivitetet e saj.

11 [Fshirë]

## **Data e konsensusit**

---

Qershor 1998

## **Data e hyrjes në fuqi**

---

Ky Interpretim hyn në fuqi për periudhat financiare vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 1999 e në vijim; inkurajohet zbatimi para kësaj date. Ndryshimet në politikat kontabël do të trajtohen në përputhje me SNK 8.

Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet në paragrafin 6 për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë standard për një periudhë më të hershme, këto ndryshime do të zbatohen edhe për periudhën më të hershme.